

ANEKSI 1

MARRËVESHJE PËR BLERJE KUOTE DHE PËRFUNDIMIN E KONTRATËS SE OPSIONIT DATE 19.12.2016

Sot, më datë 11.09.2023 (dymijë e njëzet e tre), nënshkruhet kjo marrëveshje transferimi kuote midis palëve të mëposhtme:

Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njesia bashkiake nr.2, Rruga "Papa Gjon Pali II", Ndertesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1206, Kodi Postar 1010, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K72223031K, përfaqësuar nga administratori Znj. Edlira Muka, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim "Shitësi");

- Nga njëra anë –

Investment Joti - Infosoft Group Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njesia bashkiake nr.2, Rruga "Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K91425022E, përfaqësuar nga administratori Znj. Blerta Elezaj, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim "Blerësi");

- Nga ana tjetër -

MEQËNËSE

- A. Më 19 Dhjetor 2016 Balfin dhe Infosoft kanë nënshkruar një Kontratë Opsioni për shitjen e Kuotës ("Kontrata e Opsionit") regjistruar në QKB me CN 081291-12-16 .
- B. Në datën 11 Shtator 2023, Shitësi i ka njoftuar Blerësit ushtrimin e Opsionit dhe shitjes sipas Kontratës së Opsionit dhe meqenëse Palët kanë rënë dakord të shesin kuotën me vlerë të ndryshme nga vlera nominale e saj.

Palët kanë vendosur dhe rënë dakord si më poshtë:

vijon:

1. Shitësi gëzon të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë dhe zotërimit të **1 (një)** kuote me një vlerë nominale prej **19,600.000 LEK** (nëntëmbëdhjetë milion e gjashtë qind mijë lekë), të cilat përfaqësojnë **49%** (dyzet e nëntë për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë **ITD Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën Rruga "Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NUIS: J61820049L" ("Kuota").
2. Shitësi shet, transferon dhe dorëzon pronësinë e plotë dhe zotërimin e Kuotës të cilësuar këtu më sipër, dhe të gjitha të drejtat e detyrimet që ai gëzon si ortak, ja kalon Blerësit, i cili pranon t'i blejë, për një çmim të barabartë me një vlerë prej 19,600,000 (nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëqind mijë) leke dhe 1,960,000 (një milion e nentëqind e gjashtëdhjetë mijë) Euro. (këtu e tutje referuar si "Çmimi i Shitjes").
3. Shitësi në këtë mënyrë deklaron që Kuota e transferuar në bazë të kësaj marrëveshjeje është e lirë dhe e pastër nga çdo peng, barrë siguroese, kufizim, garanci e një tjetër natyre, kufizim ose nga ndonjë

pengesë ligjore në përgjithësi.

4. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje dhe me shlyerjen e Çmimit të Shitjes brenda 10 ditëve pune nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, Shitësi nuk ka dhe nuk do të këtë ndonjë pretendim tjetër përkundrejt Blerësit në lidhje me blerjen e Kuotës së mësipërme.
5. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, Palët e konsiderojnë Kontratën e Opsionit të nënshkruar me datë 19.12.2016 të përfunduar, duke nisur nga kjo datë.
6. Pas transferimit të mësipërm të Kuotës, Shitësi nuk gëzon më asnjë të drejtë ose titull mbi Kuotën e mësipërme dhe Blerësi, të cilit kuota i është transferuar dhe dorëzuar, përsa i përket pronësisë dhe posedimit, do të gëzojë të drejtën t'a zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe disponojë ato me vullnetin e tij të lirë si pronar dhe posedues i saj. Blerësi gëzon të drejtën të ushtrojë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë.
7. Pas transferimit të mësipërm të Kuotës, Blerësi/Shoqëria ITD Shpk do të vijojë me regjistrimin e nevojshëm të transaksionit në fjalë në Regjistrin e Biznesit të mbajtur në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Regjistrin të Pronareve Përfitues.
8. Pavarësisht sa me sipër, çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj marrëveshjeje do të paraqitet për zgjidhje pranë Gjykatave kompetente të Tiranës.
9. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga të dy palët.

Kjo Marrëveshje hartohet në 2(dy) kopje me përmbajtje dhe fuqi të njëjtë ligjore nga të cilat një kopje



Shitësi

Balfin – Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.

përfaqësuar nga Znj. Edlira Muka

Blerësi

Investment Joti - InfoSoft Group Sh.p.k

përfaqësuar nga Znj. Blerta Elezaj